

# Hylli i Dritës

*Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.*

(-II ad Cor. III, 17-).

---

1. „Hylli i Dritës“ e shkollat	Fq. 441
2. Per shvillim të çashtjes agrare në Shqypni	451
3. Mémoire historique	461
4. Rreth Gramatologjis shqype	467
5. „Aga Ymeri,“ a „Konstantini?“	474
6. Kanûni i Lekë Dukagjinit	488
7. Trashigime Thrako-ilirjane	500
8. Bibljografi	504

---

SHKODER  
Shtypshkroja Franciskane  
1924.

## Lajmet

qi, prej mungeset të vëndit, nuk muj-  
tem me i rreshtue në ket Numer, do t'i  
permbledhim në Numrin XII, tuj pershî  
Ndandorin e Dhetorin.

## „Hylli i Dritës“ e shkollat.

Me ket titull fletorja „Bashkimi“ Nr. 25 mërr rasë prej kryeartikullit të Numrit të perparshem të së Perkohshmes s'onë me na diftue se në made të shkollave e të koedukacionit nuk âsht kurrkund me në jo veç, por se shkandullohet. E asercjoneve të ksajë fletore vrapon me ju u bâ „Amin“ fletorja „Dajti“ Nr. 53. Per faqe të bardhë! Prej dy fletoreve qi permendem e sidomos prej fletores „Bashkimi“, së cillës në made të. perpjekunit të religjonit me çashtje shkollore i njifen tash mâ programi edhe qellimet, sugurisht qi nuk kemi pritë lavd as të perkrahun, e prandej aj artikull nuk kje per në as gjâ e papritne, as gjâ e rë; vetem na erdh keq se prap, pa i pasë dhânë kush shkas, na nep rasë me protestue kundra disa të shprehunave per rreth rreligionit, të cillat ishin dashtë mâ të e peshue mirë para se me i shtrî në leter, pse të fyemet janë gjithmonë të fyeme edhe at herë kuer i shkakton inkompetenca në çashtje, per mos me thânë tjetër.

Si thame, pra, artikulli nuk na çuditë aspak, por po, na çuditë, e jo pak një pûnë tjetër, e kjo âsht se, sa herë qi del në shesh çashtja shkollore, do të lidhet gjithmonë per kûj t'afetarizmit. Po si s'i rà kuej nder mënd per ket afetarizem në perpjestim b. f. të vehtjeve qi marrin pjesë

